



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 12519 Prot

Lezhë, më 24. 06. 2026

**PROJEKTVENDIM**

Nr. —, Datë 24. 06. 2026

**Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”, dhe përdorim të Fondit të Kontigjencës për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2026.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkisë,

**PËR TË VENDOSUR :**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”, konkretisht:

1.1 -Të pakësohen shpenzimet në programet, funksionet, produktet dhe strukturën ekonomike në shumën 12,779,978 lekë, me këto emërtime si më poshtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	04520	V452AAB	05	602	1,285,060	Bl. materiale për mirëmbajtjen e rr.rurale
			V452AAC	05	602	97,830	Bl. materiale për sinjalistikën horizontale
		06260	V626AAH	05	602	161,908	Bl. materiale elektrike për institucionet
		06440	V644AAB	05	602	1,117,509	Bl. materiale elektrike për rrjetin urban
			V644AAC	05	602	1,117,671	Bl. materiale elektrike për rrjetin rural
2	AF127	09120	V912AAA	01	600	7,518,797	Paga
				01	601	1,255,639	Sigurime shoqërore
				05	606	225,564	Fond i veçantë

1.2 -Të shtohen shpenzimet në programin, funksionin, produktet dhe strukturën ekonomike në shumën 12,779,978 lekë, me këto emërtime si më poshtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	05100	V510AAA	01	600	8,774,436	Paga
				05	600	2,086,049	Paga
				05	601	1,813,701	Sigurime shoqërore
			V510AAB	05	231	30,000	Blerje GPS për mjetet teknologjike
				05	602	44,512	Shërbimi i mirëmbajtjes së GPS-ve
			V510AAC	05	231	11,280	Blerje GPS për mjetet teknologjike
				05	602	20,000	Shërbimi i mirëmbajtjes së GPS-ve

1.3 Të shtohet numri i punonjësve për vitin 2026 në Programin Buxhetor AD127, në Funkcionin 05100 “Menaxhimi i Mbetjeve”

1.3.1. Për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor 2026 - 20 vetë (8 shoferë dhe 12 punonjës ekologjik).

1.3.2. Për periudhën 1 Korrik – 15 Shtator 2026 - 6 vetë (Punonjës shërbimesh për pastrimin).

2. Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 1,050,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2026, konkretisht:

2.1 Të pakësohen shpenzimet në programin, funksionin, produktin dhe strukturën ekonomike, me emërtim si më poshtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	04940	V494AAA	01	609	1,050,000	Fondi i Kontigjencës

2.2 Të shtohen shpenzimet në programin, funksionin, produktet dhe strukturën ekonomike, me emërtime si më poshtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	05100	V510AAA	01	600	899,743	Paga
				01	601	150,257	Sigurime shoqërore

3. Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen: Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, Drejtorja e Menaxhimit të Mbetjeve, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit & Drejtorja Juridike.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 12519/ Prot.

Lezhë, më 24. 06 . 2026

**RELACION**

**LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR DISA SHTESA DHE  
NDRYSHIME NË BUXHETIN E VITIT 2026, DHE PËRDORIM I FONDIT TË  
KONTIGJENCËS PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË PAPANASHIKUARA**

Të nderuar këshilltarë,

Ju paraqesë kërkesën për disa shtesave dhe ndryshimeve në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026” dhe për përdorim të Fondit të Kontigjencës për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin 2026, në Programin Buxhetor AD127 dhe AF127, për disa funksione dhe produkte me vlerat përkatëse, duke ju dhënë këto argumenta të arsyeshme:

- Në kuadër të zgjerimit të shërbimit të pastrimit, frekuencave të evadimit të mbetjeve, nevojave për mbulimin e këtij shërbimi në 7 ditët e javës, mbrojtjes të të drejtave në punë të punonjësve që merren me këtë shërbim dhe për të mundësuar një efikasitet e efikasitet në kryerjen e tij, kërkohen burime njerëzore dhe mbështetje me fonde shtesë për këtë shërbim. Gjithashtu për periudhën e sezonit turistik është e domosdoshme të shtohen edhe 6 punonjës pastrimi për zonën turistike të Shëngjinit.
- Numri i punonjësve që kërkohet të shtohen për periudhën 01 Korrik - 31 Dhjetor është për 20 punonjës (8 shoferë dhe 12 punonjës ekologjik), ndërsa për periudhën 01 Korrik - 15 Shtator është për 6 punonjës për pastrimin e hapësirave në zonën turistike.
- Për të rritur kontrollin dhe monitorimin e shërbimit të evadimit të mbetjeve, menaxhimin e itinerareve dhe konsumin e karburantit paraqitet nevoja për pajisjen e mjeteve me GPS.
- Fondet që kërkohen për mbulimin e këtyre shpenzimeve, si rezultat i shtimit të numrit të punonjësve dhe për blerjen e pajisjeve GPS dhe shërbimi i mirëmbajtjes së tyre, do të alokohen nga fondet e krijuara si tepriçë mes fondit limit të parashikuar në buxhet dhe vlerave të kontraktuara për blerjen e disa mallrave dhe materialeve, si dhe nga përdorimi i Fondit të Kontigjencës, i cili është planifikuar për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuar në buxhet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj,

**KRYETARI**  
Pjerin Ndrecu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 10735 Prot.

Lezhë, më 19.06.2026

Miratoi:

Kryetari i Bashkisë

Pjerin Ndreu

Lënda:

Kërkesë për ndryshim buxheti



DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

“KËTU”

Referuar shkresës nr. 10735 prot., datë 01.06.2026, me lëndë “Kërkesë për hapjen e pozicioneve të reja të punës”, të Drejtorisë së Menaxhimit të Mbetjeve, Vendimit nr. 113 datë 15.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”, të Këshillit të Bashkisë Lezhë, kërkoj nga ana juaj parashikimin e buxhetit për 20 (njëzet) punonjës që do të shtohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbetjeve, përkatësisht:

- 8 (tetë) pozicione “Shoferë ekologjikë”,
- 12 (dymbëdhjetë) pozicione “Punëtorë Ekologjikë”
- 6 (gjashtë) pozicione “Punëtorë Shërbimesh Sezonalë me Kontratë”.

Punonjësit e sipërcituar do të paguhen nga fondet e veta të Bashkisë Lezhë, me fondet e alokuara nga tepricat.

Shtimi i numrit të punonjësve bëhet me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, rritjen e eficiencës në mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve, si dhe përmirësimin e standardeve të pastërtisë dhe higjienës në territorin e Bashkisë Lezhë.

Bashkia Lezhë ka si objektiv parësor ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit urban dhe rural, duke synuar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe të qëndrueshëm për komunitetin. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve, në mbrojtjen e mjedisit dhe në krijimin e një imazhi pozitiv për qytetin.

Gjithashtu, mbajtja e qytetit dhe zonave turistike në standarde të larta pastërtie përbën një element të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal, rritjen e potencialit turistik dhe krijimin e kushteve më të favorshme për vizitorët dhe investitorët. Një mjedis i pastër dhe i mirëadministruar kontribuon në rritjen e konkurrueshmërisë së Bashkisë Lezhë në raport me njësitë e tjera vendore.

Bashkëlidhur gjeni:

Shkresën nr. 10735 prot., datë 01.06.2026, me lëndë "*Kërkesë për hapjen e pozicioneve të reja të punës*", të Drejtorisë së Menaxhimit të Mbetjeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI**  
**Jetmira Leka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTOARIA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Nr. 11572 Prot

Lezhë 16.6.2026

MIRATOHET  
KRYETARI  
Pjerin NDREU



**Lënda:** Kërkesë për ndryshim në buxhetin e vitit 2026, në programet buxhetore AD127 dhe AF127

**DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT**

**KETU**

Në mbështetje të ligjit të 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore “, neni 64 gërma a, neni 23, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë:” i ndryshuar, në VKB, nr.113 datë 15.12.2025 “ Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetin e vitit 2026”, i ndryshuar, kërkojmë që në buxhetin e vitit 2026, të bëhen ndryshimet e mëposhme:

**Të shtohen këto shpenzime në funksionet:**

Nr	Progr.	Funksioni	Produkti	Kapitulli	Artikulli	Emërtimi	Shuma
1	AD127	05100	V510AAA	05	600	Paga për punonjësit e Dejtorisë së Menaxhimit të Mbetjeve	10,860,485
2	AD127	05100	V510AAA	05	601	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit.	1,813,701
4.	AD127	05100	V510AAB	05	231	Blerje GPS për mjetet teknologjike për zonën urbane	30,000
5	AD127	05100	V510AAC	05	231	Blerje GPS për mjetet teknologjike për zonën rurale	11,280
6	AD127	05100	V510AAB	05	602	Shërbim për mirëmbajtje të GPS, për mjetet teknologjike për zonën urbane	44,512
7	AD127	05100	V510AAC	05	602	Shërbim për mirëmbajtje të GPS, për mjetet teknologjike për zonën urbane	20,000
<b>TOTALI</b>							<b>12,779,978</b>

**Të pakësohen këto shpenzime në funksionet:**

Nr	Progr.	Funksioni	Produkti	Kapitulli	Artikulli	Emërtimi	Shuma
1	AF127	09120	V912AAA	05	600	Paga të stafit të arsimit bazë	7,518,797
2	AF127	09120	V912AAA	05	601	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të stafit të arsimit bazë	1,255,639
3	AF127	09120	V912AAA	05	606	Fondi i veçantë për stafit të arsimit baze	225,564
6	AD127	04520	V452AAB	05	602	Blerje material për mirëmbajtjen e rrugeve rurale	1,285,060
7	AD127	04520	V452AAC	05	602	Sinjalistikë horizontale për rruget rurale	97,830
8	AD127	06440	V644AAB	05	602	Materiale elektrike për rrjetin urban	1,117,509
9	AD127	06440	V644AAC	05	602	Materiale Elektrike për rrjetin Rural	1,117,671
10	AD127	06260	V626AAH	05	602	Materiale elektrike per institucionet	161,908
<b>TOTALI</b>							<b>12,779,978</b>

Bashkëlidhur kësaj kërkesë, ju dërgojmë relacionin shpjegues.

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.**

**DREJTORIA E MENAXHIMIT TE MBETJEVE**

**DREJTORI**

**Kristina Sumaj**

**DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT**

**DREJTORI**

**Aurora Gjeloši**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE MJEDIST**

**Jurgen Marku**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Nr. 11572/1 Prot

Lezhë 16.06.2026

RELACION SHPJEGUES

“Për ndryshime në buxhetin e vitit 2026, në programin buxhetor AD127 dhe AF127

**DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT**

**KETU**

Në mbështetje të ligjit të 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore “, neni 64 gërma a, neni 23, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë:” i ndryshuar, paraqesim nevojën për kryerjen e ndryshimeve në buxhetin e vitit 2026 si më poshtë :

**1. Shtimin e pozicioneve në strukturën organike**

Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve ka në administrim 12 automjete teknologjike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve. Aktualisht, në strukturë janë të miratuar 10 shoferë ekologjikë dhe 18 punëtorë ekologjikë.

Duke marrë në konsideratë zgjerimin e shërbimit të pastrimit, frekuencat e pastrimit, nevojën për mbulimin e ditëve të pushimit javor dhe festave zyrtare, si dhe garantimin e zëvendësimeve gjatë pushimeve vjetore apo mungesat e përkohshme të punonjësve, numri aktual i punonjësve rezulton i pa mjaftueshëm për përbalimin normal të shërbimit. Për sa më sipër, kërkohet shtim në strukturën organike të Drejtorisë së menaxhimit të Mbetjeve:

- 8 ( tetë) pozicioneve “Shoferë ekologjikë”;
- 12 (dymbëdhjetë) pozicione “Punëtorë ekologjikë”;
- 6 ( gjashtë) pozicione punëtorë sezonal

Për 20 punonjësit ( 8 shoferë dhe 12 punetoret teknologjikë) fondi i nevojshëm për pagave dhe sigurimet shoqërore është 12,674,186 lekë, nga të cilat 9,000,000 lekë, propozohet në merren nga tepricat e fondeve në programin buxhetor AF127 “Rinia, Arsimi dhe Sporte “, në funksionin 09120, produkti V912AAA “Shërbime mbështetëse të stafit të arsimit baze” ( paga, sigurime dhe fond i vecantë ). Kjo tepricë është krijuar si rezultat i ndryshimeve në strukturën organizative, ku 15 punonjës kanë kaluar nga Njësia e Menaxhimit në Arsim, në strukturën që financohet nga Buxheti i Shtetit me transfertë specifike, duke bërë që shpenzimet për pagat dhe kontributet e tyre të mos mbulohej më nga fondet e Bashkisë Lezhë siç është planifikuar në fillim të vitit buxhetor. Për këtë arsye, një pjesë e fondeve të alokuara ka mbetur e papërdorur, duke krijuar tepricë në

buxhetin e institucionit dhe mund të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të tjera të bashkisë sipas nevojës.

Diferenca e mbetur prej 3,674,186 lekë propozohet të merret nga tepicat e krijuar nga lidhja e kontratës me nr. REF -77845-03-02-2026 “ Blerje material për mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, sistemit të ujitjes dhe kullues në Bashkinë Lezhë”, të cilat i përkasin programit AD127 “Infrastruktura, Mjedisit dhe Shërbimet publike”, në produktet V452AAB “Blerje material për mirëmbajtjen e rrugëve rurale”, V452AAC “Sinjalistikë horizontale”, V644AAB “ Materiale elektrike për rrjetin urban”, V644AAC “Materiale elektrike për rrjetin rural” dhe V626AAH “Materiale elektrike për institucionet”. Për 6 punonjësit sezonal fondi pagave dhe sigurimeve prej 1,050,000 lekë, propozohet të merret nga fondi i kontigjencës.

## **2. Blerje GPS dhe shërbim për mirëmbajtje e tij.**

Për të rritur kontrollin dhe monitorin e shërbimit të pastrimit, si dhe për përmirësuar menaxhimin e itineraneve, konsumin e karburantit, paraqitet nevoja për pajisjen e mjeteve me GPS.

Në buxhet e vitit 2026, është parashikuar një fond 120,000 lekë, për “Blerje GPS”, por fondi nuk i mbulon plotësisht nevojat e drejtorisë për të gjitha mjetet, pasi është planifikuar për 10 mjete, ndërkohë Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve disponon 14 mjete. Po kështu në buxhetin e vitit 2026, nuk është parashikuar shërbimi i mirëmbajtjes GPS.

Për këtë qëllim kërkohet një shtesë fondi në vlerën:

- 41,280 lekë për “Blerje GPS”
- 64,512 lekë “Për shërbimin e mirëmbajtjes të GPS”,

Ky fond do të mbulohet nga tepricat e krijuara nga lidhja e kontratës së sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i ndryshimeve të propozuara sipas kërkesës bashkëngjitur.

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.**

Drejtori  
Kristina Sumaj